



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacije - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

RAPORT

**ORGANIZIMI I MËSIMIT PLOTËSUES PËR NXËNËSIT QË KANË SHFAQUR NGECJE NË
ARRITJEN E REZULTATEVE SI PASOJË E COVID-19**

Prishtinë, 2021

Përmbajtja:

Hyrja.....	03
Organizimi dhe zhvillimi i mësimit plotësues në shkollë.....	04

FUSHAT DHE LËNDËT KURRIKULARE:

Gjuhët dhe komunikimi.....	04
Matematikë.....	06
Biologji.....	08
Fizikë.....	10
Kimi.....	12

KONSTATIMI.....	15
REKOMANDIMET.....	16

Hyrje

Përhapja e pandemisë COVID-19, ka paraqitur vështirësi dhe sfida të mëdha në shumë dimensione edhe në vendin tonë dhe në veçanti kjo situatë ka reflektuar edhe në procesin edukativo-arsimor. Andaj, si rezultat i kësaj situatë të krijuar, organizimi i procesit mësimor për vitin shkollor 2020-2021, është zhvilluar sipas skenarëve A, B dhe C të përcaktuar sipas udhëzuesit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID 19. Por, kalimi nga një skenar në skenarin tjetër, është konstatuar se ka shkaktuar shumë probleme. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk kanë arritur të përcjellin mësimin dhe të arrijnë të përmbushin rezultatet e të nxënësve të parapara me programet mësimore-lëndore, si pasojë e mungesës së pajisjeve dhe qasjes në internet etj.

Pandemia COVID-19, ka ndikuar dhe rezultuar në humbjen e orëve mësimore në nivelin e arsimit parauniversitar në të gjithë vendin dhe në veçanti duke thëlluar edhe më tej edhe më pabarazinë në mes fëmijëve-nxënësve. Përballë qasjes së pabarabartë në të mësuar në distancë dhe kohës së zvogëluar të mësimdhënies, nxënësit që vijnë nga familjet me të ardhura të ulëta, nxënësit e komuniteteve dhe ata me nevoja të veçanta, janë në rrezik të veçantë të mbesin pas.

Faktet dëshmojnë se humbja e orëve mësimore të nxënësve është shqetësuese për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, por te nxënësit e nivelit fillor (I-V), efektet mund të jenë afatgjate për vitet në vazhdim dhe gjithashtu kjo mund të shkaktoj ankth, stres edhe te stafi arsimor, fëmijët-nxënësit dhe familjet e tyre.

Andaj, nga vlerësimi i gjendjes, është konstatuar se organizimi i mësimit plotësues është një prej mundësive që do të lehtësonte humbjen e mësimit, përshpejtimin e të nxënësve dhe përmirësimin e arritjeve të rezultateve të nxënësve.

Në koordinim dhe bashkëveprim me gjithë akterët e përfshirë në procesin arsimor dhe në veçanti mësimdhënësit të cilët/at nëpërmjet formave interaktive të komunikimit dhe verifikimit të informacioneve/përvojave të mësimit, kanë nxjerrë në pah dhe kanë identifikuar ngeçjet e nxënësve në mësim si dhe kanë planifikuar forma për përkrahjen e nxënësve në arritjen dhe përmbushjen me sukses të rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave të përcaktuara në programin mësimor-lëndor, përmes organizimit të mësimit plotësues, për nxënësit e klasave (I-XII).

Procesi i organizimit dhe mbajtjes së mësimit plotësues për të gjithë nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar të cilët pas identifikimit nga mësimdhënësit se kanë ngeçje në të nxënësve dhe pas planifikimit, ky proces ka filluar në të gjitha komunat e Republikës nga 7 maji i vitit 2021 dhe ka vazhduar deri në përfundim të vitit mësimor.

Organizimi dhe zhvillimi i mësimit plotësues në shkolla

Drejtoritë Komunale të Arsimit, në koordinim dhe bashkëveprim me shkollat, kanë hartuar planin për organizimin e mësimit plotësues sipas udhëzimeve të MASHTI, për të gjithë nxënësit që kanë humbur mësimin gjatë periudhës së parë dhe të dytë të vitit shkollor 2020-2021 dhe për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve të parapara me programin mësimor-lëndor.

Për organizimin e punës me nxënës, që kanë humbur mësim dhe me nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve, është kërkuar të zhvillohet aktivitet i ngjeshur pedagogjik i mësimdhënësve dhe i shërbimit pedagogjik-psikologjik të shkollës.

Format e punës në institucionet edukativo-arsimore që janë planifikuar dhe zbatuar nga mësimdhënësit gjatë periudhës së tretë, duke i mbajtur nxënësit të angazhuar dhe të fokusuar drejt arritjes së rezultateve të të nxënësve, të cilat nuk kanë arritur që t'i zotërojnë gjatë periudhës së parë dhe të dytë, si rezultat i rrethanave të krijuara nga përhapja e pandemisë COVID-19.


Nga data 7 maj 2021, mësimi plotësues është organizuar dhe zhvilluar në fushat kurrikulare: Gjuhë amtare, matematikë dhe shkencat natyrore, ku mësimin e kanë vijuar gjithsej **181630 nxënës nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën (I-XII)**, apo **61.64 përqind** e nxënësve në nivel vendit, duke i realizuar gjithsej **100365 orë** mësimore.

Gjuhët dhe komunikimi

Nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm i raporteve komunale, konstatohet se në fushën Gjuhët dhe komunikimi mësimet plotësues nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën (I-XII), në nivel vendi i kanë vijuar gjithsej **62485 nxënës, apo 21.21 përqind** të nxënësve, duke i realizuar **37535 orë mësimore**. Pra, nga vlerësimi i raporteve vërehet se ky proces i organizimit të mësimit plotësues për nxënësit që kanë pasur ngecje si pasojë e situatës pandemike ka reflektuar dhe ka pasur impakt pozitiv në arritjen e rezultateve të nxënësve.

Në vijim paraqesim tabelën për nxënësit që kanë mbajtur mësimin plotësues në lëndën gjuhët dhe komunikimi:

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i nxënësve klasa (I-XII)	Numri i nxënësve pjesëmarrës në lëndën Gjuha amtare (Gj. shqipe, Gj. turke. Gj. boshnjake)	Përqindja	Numri i orëve të realizuara
1	Deçan	4860	2265	46.60	1547
2	Dragash	3093	1498	48.43	1143
3	Ferizaj	21429	5934	27.69	1614
4	F. Kosovë	8883	789	8.88	337
5	Gjakovë	14880	3269	21.97	1676
6	Gjilan	15036	3902	25.95	2333
7	Gllgovc	10719	4146	38.68	1347
8	H. i Elezit	1670	317	18.98	300
9	Istog	6252	908	14.52	271
10	Junik	695	489	70.36	284
11	Kaçanik	5529	1664	30.10	1068
12	Kamenicë	3622	984	27.17	831
13	Klinë	6772	1643	24.26	1481
14	Leposaviq	16	16	100.00	78
15	Lipjan	11123	6040	54.30	4615
16	Malishevë	10545	3008	28.53	1504
17	Mamushë	831		0.00	
18	Mitrovicë	14245	1686	11.84	353
19	Novobërdë	506	215	42.49	190
20	Obiliq	3689	970	26.29	733
21	Pejë	16034	4723	29.46	2619
22	Podujevë	15776		0.00	
23	Prishtinë	39791	5714	14.36	2219
24	Prizren	27189	2757	10.14	2710
25	Rahovec	8313	2842	34.19	1334
26	Shtërpcë	499	215	43.09	273
27	Shtime	4920	1178	23.94	1204
28	Skënderaj	8588	1386	16.14	1588
29	Suharekë	9454		0.00	
30	Viti	7204	1227	17.03	1115
31	Vushtrri	12225	2530	20.70	2624
32	Zubin Potok	92	32	34.78	66
33	Zveçan	66	47	71.21	58
34	Klllokot	104	91	87.50	20
Gjithsej		294650	62485	21.21	37535




Graf. 1. Paraqitja e numrit të nxënësve që kanë mbajtur mësimin plotësues si dhe numri i orëve të realizuara.

Matematikë

Në këtë fushë të kurrikulës nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm i raporteve komunale lidhur me organizimin dhe mbajtjen e mësimit plotësues, konstatohet se mësimin plotësues nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën (I-XII), në nivel vendi e kanë vijuar **56820 nxënës, apo 19.28 përqind** e nxënësve, duke i realizuar gjithsej **32705 orë mësimore**. Pra, nga vlerësimi i raporteve, vërehet se në këtë fushë kurrikulare mësimin plotësues e kanë vijuar një numër i konsiderueshëm i nxënësve të cilët kanë pasur ngecje apo humbje të orëve mësimore si rezultat i pandemisë dhe sigurisht ky proces ka ndikuar sadopak në lehtësimin e arritjeve të rezultateve të parapara me programin mësimor nga nxënësit.

Në vijim paraqesim tabelën me numrin e përgjithshëm të nxënësve dhe përqindjen e tyre në nivel vendi të cilët nga 07 maj i vitit 2021, kanë mbajtur mësimin plotësues në lëndën e matematikës dhe numrin e orëve të realizuara.

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i nxënësve klasa (I-XII)	Numri i nxënësve pjesëmarrës në lëndën e matematikës	Përqindja	Numri i orëve të realizuara
1	Deçan	4860	2346	48.27	1720
2	Dragash	3093	1479	47.82	1160
3	Ferizaj	21429	4729	22.07	1428
4	F. Kosovë	8883	981	11.04	344
5	Gjakovë	14880	3371	22.65	697
6	Gjilan	15036	3831	25.48	2246
7	Glllogovc	10719	4403	41.08	1335
8	H. i Elezit	1670	318	19.04	266
9	Istog	6252	917	14.67	263
10	Junik	695	570	82.01	244
11	Kaçanik	5529	1662	30.06	1014
12	Kamenicë	3622	1043	28.80	825
13	Klinë	6772	1788	26.40	1494
14	Leposaviq	16	16	100.00	58
15	Lipjan	11123	1425	12.81	4158
16	Malishevë	10545	3042	28.85	673
17	Mamushë	831		0.00	
18	Mitrovicë	14245	1709	12.00	358
19	Novobërdë	506	214	42.29	194
20	Obiliq	3689	959	26.00	931
21	Pejë	16034	5053	31.51	2586
22	Podujevë	15776		0.00	
23	Prishtinë	39791	6058	15.22	2162
24	Prizren	27189	1282	4.72	1141
25	Rahovec	8313	2945	35.43	716
26	Shtërpcë	499	240	48.10	266
27	Shtime	4920	1160	23.58	1151
28	Skënderaj	8588	1405	16.36	1615
29	Suharekë	9454		0.00	
30	Viti	7204	1260	17.49	1037
31	Vushtrri	12225	2443	19.98	2485
32	Zubin Potok	92	29	31.52	68
33	Zveçan	66	51	77.27	51
34	Klllokot	104	91	87.50	19
Gjithsej		294650	56820	19.28	32705



Graf. 2. Paraqitja e numrit të nxënësve që kanë mbajtur mësim plotësues si dhe numri i orëve të realizuara.

SHKENCAT NATYRORE


Biologji

Nga vlerësimi i raporteve të dërguara nga komunitat, në këtë lëndë mësimore konstatohet se një numër i mjaftueshëm i nxënësve nga të dy nivelet e arsimit parauniversitar e kanë vijuar mësimin plotësues në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara me programin mësimor, mbase viti shkollor 2020-2021, na ka përcjellë me sfida dhe vështirësi të shumta si pasojë e pandemisë COVID-19.

Në nivel vendi, mësimin plotësues e kanë vijuar **22856 nxënës** të klasave (I-XII), apo **7.76 përqind** të nxënësve në nivel vendi, duke i realizuar **10123 orë mësimore**.

Në vijim paraqesim tabelën për numrin e përgjithshëm të nxënësve dhe përqindjen e tyre në nivel vendi të cilët kanë mbajtur mësimin plotësues në lëndën e biologjisë dhe numrin e orëve të realizuara.

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i nxënësve klasa (I-XII)	Numri i nxënësve pjesëmarrës në lëndën e biologjisë	Përqindja	Numri i orëve të realizuara
1	Deçan	4860	950	19.55	506.0
2	Dragash	3093	443	14.32	383.0
3	Ferizaj	21429	2758	12.87	724
4	F. Kosovë	8883	318	3.58	186
5	Gjakovë	14880	1157	7.78	298.0
6	Gjilan	15036	1159	7.71	657
7	Gllogovc	10719	1922	17.93	494
8	H. i Elezit	1670	116	6.95	124.0
9	Istog	6252	257	4.11	85
10	Junik	695	172	24.75	55.0
11	Kaçanik	5529	438	7.92	296
12	Kamenicë	3622	390	10.77	330
13	Klinë	6772	621	9.17	361
14	Leposaviq	16	7	43.75	16
15	Lipjan	11123	1906	17.14	1241
16	Malishevë	10545	1042	9.88	266
17	Mamushë	831		0.00	
18	Mitrovicë	14245	561	3.94	92
19	Novobërdë	506	91	17.98	75
20	Obiliq	3689	346	9.38	204
21	Pejë	16034	1600	9.98	726
22	Podujevë	15776		0.00	
23	Prishtinë	39791	2047	5.14	675
24	Prizren	27189	1119	4.12	
25	Rahovec	8313	1002	12.05	255
26	Shtërpcë	499	70	14.03	107
27	Shtime	4920	435	8.84	129
28	Skënderaj	8588	605	7.04	627
29	Suharekë	9454		0.00	
30	Viti	7204	467	6.48	373
31	Vushtrri	12225	788	6.45	792
32	Zubin Potok	92	16	17.39	32
33	Zveçan	66	27	40.91	6
34	Kllokot	104	26	25.00	8
Gjithsej		294650	22856	7.76	10123



Graf. 3. Paraqitja e numrit të nxënësve që kanë mbajtur mësim plotësues në lëndën e biologjisë si dhe numri i orëve të realizuara.

Fizikë


Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve komunale, konstatohet se një numër i mjaftueshëm i nxënësve të nivelit të arsimit të mesëm të ulët dhe atij të mesëm të lartë, i kanë vijuar mësimet plotësuese, që janë konsideruar se kanë pasur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e situatës pandemike, e cila na ka shoqëruar gjatë vitit shkollor 2020-2021.

Pra, nga të dhënat e përpunuara, konstatohet se mësimet plotësuese i kanë vijuar **21293 nxënës** apo **7.23 përqind** në nivel vendi, duke i realizuar gjithsej **10571 orë mësimore**.

Në vijim paraqesim tabelën për numrin e përgjithshëm të nxënësve dhe përqindjen e tyre në nivel vendi të cilët kanë mbajtur mësimin plotësues.

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i nxënësve klasa (I-XII)	Fizikë		
			Numri i nxënësve pjesëmarrës në lëndën e fizikës	Përqindja	Numri i orëve të realizuara
1	Deçan	4860	989	20.35	483
2	Dragash	3093	395	12.77	382
3	Ferizaj	21429	2884	13.46	670
4	F. Kosovë	8883	319	3.59	150
5	Gjakovë	14880	1174	7.89	279
6	Gjilan	15036	1183	7.87	740

7	Glogovc	10719	2062	19.24	493
8	H. i Elezit	1670	122	7.31	145
9	Istog	6252	256	4.09	83
10	Junik	695	186	26.76	92
11	Kaçanik	5529	474	8.57	319
12	Kamenicë	3622	404	11.15	341
13	Klinë	6772	678	10.01	409
14	Leposaviq	16	7	43.75	15
15	Lipjan	11123	730	6.56	1186
16	Malishevë	10545	1090	10.34	272
17	Mamushë	831		0.00	
18	Mitrovicë	14245	568	3.99	83
19	Novobërdë	506	61	12.06	75
20	Obiliq	3689	384	10.41	218
21	Pejë	16034	1735	10.82	746
22	Podujevë	15776		0.00	
23	Prishtinë	39791	2112	5.31	672
24	Prizren	27189		0.00	
25	Rahovec	8313	1079	12.98	270
26	Shtërpcë	499	116	23.25	123
27	Shtime	4920	369	7.50	282
28	Skënderaj	8588	642	7.48	621
29	Suharekë	9454		0.00	
30	Viti	7204	377	5.23	373
31	Vushtrri	12225	831	6.80	1003
32	Zubin Potok	92	13	14.13	30
33	Zveçan	66	27	40.91	7
34	Klllokot	104	26	25.00	9
Gjithsej		294650	21293	7.23	10571



Graf. 4. Paraqitja e numrit të nxënësve që kanë mbajtur mësim plotësues në lëndën e fizikës si dhe numri i orëve të realizuara.

Kimi


Pas analizës dhe vlerësimit të raporteve të drejtorive komunale të arsimit, konstatohet se edhe në lëndën e kimit mësimet plotësuese i kanë vijuar një numër i mjaftueshëm i nxënësve, të cilët kanë pasur nevojë për organizim të mësimit plotësues për arritjen e rezultateve të përcaktuara.

Nga vlerësimi i përgjithshëm konstatohet se mësimin plotësues në lëndën e kimit kanë vijuar gjithsej **18176 nxënës** apo **6.17 përqind** në nivel vendi, duke realizuar gjithsej **9431 orë mësimore**.

Në vijim prezentojmë të dhënat e detajuara:

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i nxënësve klasa (I-XII)	Fizikë		
			Numri i nxënësve pjesëmarrës në lëndën e kimit	Përqindja	Numri i orëve të realizuara
1	Deçan	4860	714	14.69	377
2	Dragash	3093	382	12.35	299
3	Ferizaj	21429	2301	10.74	505
4	F. Kosovë	8883	274	3.08	126
5	Gjakovë	14880	852	5.73	148

6	Gjilan	15036	897	5.97	503
7	Glogovc	10719	2240	20.90	459
8	H. i Elezit	1670	54	3.23	93
9	Istog	6252	239	3.82	53
10	Junik	695	192	27.63	26
11	Kaçanik	5529	334	6.04	208
12	Kamenicë	3622	341	9.41	237
13	Klinë	6772	517	7.63	280
14	Leposaviq	16	4	25.00	11
15	Lipjan	11123	1508	13.56	2694
16	Malishevë	10545	811	7.69	217
17	Mamushë	831		0.00	
18	Mitrovicë	14245	415	2.91	47
19	Novobërdë	506	41	8.10	35
20	Obiliq	3689	275	7.45	147
21	Pejë	16034	1279	7.98	529
22	Podujevë	15776		0.00	
23	Prishtinë	39791	1746	4.39	506
24	Prizren	27189		0.00	
25	Rahovec	8313	826	9.94	239
26	Shtërpcë	499	61	12.22	88
27	Shtime	4920	307	6.24	218
28	Skënderaj	8588	475	5.53	426
29	Suharekë	9454		0.00	
30	Viti	7204	355	4.93	266
31	Vushtrri	12225	700	5.73	661
32	Zubin Potok	92	10	10.87	24
33	Zveçan	66	14	21.21	3
34	Klllokot	104	12	11.54	6
Gjithsej		294650	18176	6.17	9431



Graf. . Paraqitja e numrit të nxënësve që kanë mbajtur mësim plotësues në lëndën e kimisë si dhe numri i orëve të realizuara.

KONSTATIM

Nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm konstatohet se viti shkollor 2020-2021, na ka përcjellë me sfida dhe vështirësi të shumta në shumë dimensione edhe në proceset arsimore, si pasojë e pandemisë COVID-19, gjë që ka ndikuar edhe në organizimin e mësimit sipas skenarëve të ndryshëm, duke reflektuar edhe në humbjen e orëve mësimore.

Duke e analizuar dhe vlerësuar ecurinë dhe zhvillimin e procesit të mësimit gjatë periudhës së parë dhe të dytë të vitit shkollor 2020-2021, është vërejtur që procesi mësimor është përcjellë me peripeci të shumta, gjë që ka reflektuar në humbjen e orëve mësimore dhe ngecjen e nxënësve në të nxënë. Atëherë, për t'ju përgjigjur në mënyrë profesionale kësaj situatë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërmoi hapat e mundshëm për të lehtësuar këtë gjendje, duke planifikuar dhe organizuar mësim plotësues për nxënësit të cilët kanë ngecje në arritjen e rezultateve. Pra, mësimi plotësues u organizua në koordinim dhe bashkëveprim me DKA-të dhe institucionet edukativo-arsimore në nivel vendi nga data 7 maj 2021, deri në përfundim të vitit shkollor.

Mësimi plotësues u organizua në fushat, gjuhët dhe komunikimi, matematikë dhe shkencat natyrore, ku nevoja për organizimin dhe mbajtjen e mësimit plotësues ishte më e domosdoshme. Nga data 7 maj 2021 deri në fund të vitit shkollor mësimet plotësuese i vijuan gjithsej **181630 nxënës** nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën apo **61.64 përqind** e nxënësve në nivel vendi, duke i realizuar gjithsej **100365 orë mësimore**. Por, duhet cekur se tri komuna nuk kanë prezantuar të dhëna që kanë organizuar dhe mbajtur mësim plotësues dhe ndër to janë: Komuna e Podujevës, Suharekës dhe Mamushës. Sigurisht që procesi i organizimit të mësimit plotësues ka reflektuar dhe ndihmuar sadopak nxënësit në arritjen e rezultateve dhe kompensimin e mësimit të humbur.

Mësimi plotësues u zhvillua në këto fusha kurrikulare:

1. Gjuhët dhe komunikimi, e kanë vijuar 62485 nxënës nga klasa e parë në të dymbëdhjetë, apo 21.21 përqind të nxënësve në nivel vendi, duke i realizuar 37535 orë mësimore;
2. Matematikë, mësimin e kanë vijuar 56820 nxënës nga klasa (I-XII), apo 19.28 përqind, duke i realizuar 32705 orë mësimore;
3. Biologji, mësimin e kanë vijuar 22856 nxënës nga klasa (VI-XII), apo 7.76 përqind, duke realizuar 10123 orë mësimore;
4. Fizikë, mësimin e kanë vijuar 21293 nxënës nga klasa (VI-XII), apo 7.23 përqind, duke realizuar gjithsej 10571;
5. Kimi, mësimin e kanë vijuar 18176 nxënës nga klasa (VII-XII), apo 6.17 përqind, duke realizuar gjithsej 9431 orë mësimore.

REKOMANDIME

1. Organizimi dhe mbajtja e mësimit plotësues duhet të planifikohet edhe për vitin shkollor 2021-2022, për nxënësit që kanë ngecje në të nxënë.
2. Të identifikohen nxënësit se në cilat fusha, lëndë kanë nevojë për mbështetje në arritjen e rezultateve sipas planprogramit mësimor-lëndor.
3. Të identifikohen nxënësit me gjendje sociale më të dobët duke i specifikuar nevojat elementare të tyre për t'i ndihmuar kësaj kategorie në krijimin e mundësisë që të jenë të barabartë në procesin e mësimnxënies krahas moshatarëve të tyre.